



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-23545

Dt. 01.12.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Faza (Idriz) Sadrija** nga fshati Ujz, komuna e Gjakovës, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit me destinim – Shtallë për viça dhe hangarit për ushqim të tyre, me etazhitet P+0, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenit 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97 bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: Aplikuesit: Faza (Idriz) Sadrija nga fshati Ujz, komuna e Gjakovës, ndërtimi i objektit me destinim – Shtallë për viça dhe hangarit për ushqim të tyre, sipas projektit kryesor të prezentuar, (me vërejtjet e poshtë shënuara), në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351/01-19663, të datës 19.10.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me numër 494/3, Z.K. Ujz, në pronësi të lartë përmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+0, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit $S = 426.40 \text{ m}^2$.

Shtalla: (Sip. Bruto): $S = 323.10 \text{ m}^2$

Hangari: (Sip. Bruto): $S = 103.30 \text{ m}^2$

Vërejtje: Kjo Leje ndërtimi ipet me vërejtje si në vijim.

• Meqenëse aplikuesi e ka plotësuar në tërësi dokumentacionin e nevojshëm për paisje me Leje Të Ndërtimit, përveq Pëlqimit për shndërrimin e tokës bujqësore në jo bujqësore nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, por e njëjta drejtori ka lëshuar Njoftimin e datës 01.12.2017, përmes të së cilit na është rekomanduar që DUMM-ja të procedojë më tutje me Leje Ndërtimi, ndërsa DBPZHR merr obligim për përfundimin e procedurës për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë jo bujqësore.

• Investitori obligohet që në momentin që të sigurohet Pëlqimi i sipër cekur, nga DBPZHR që një kopje të të Njëjtë ta prezantoj në DUMM.


II. Hartimin e projektit kryesor me destinim: ndërtimi i stallës për viça dhe hangarit për ushqim të tyre, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese "INEX- PROJECT"-Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar që:

- Të ruaj një ekzemplar original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Pa pëlqimin e hartuesit të projektit ideor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.



Arsyetim

Faza (Idriz) Sadrija nga fshati Ujz, komuna e Gjakovës, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me 07/351/01-23545 të datës 21.11.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit, ndërtimi i objektit me destinim – Shtallë për viça dhe hangarit për ushqim të tyre, me etazhitet P+0, në ngastrën kadastrale me numër 494/3, Z.K. Ujz, në pronësi të lartë përmendurit, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 12.09.2017, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 05.10.2017 në pronësi të Abedin (Ramzi) Gashi nga fshati Ujz, komuna e Gjakovës, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronë e paluajtshme me numër të lëndës 1856/17, të datës 05.10.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Aktin Noterial – Autorizim me nr, LRP.nr.rendor 4592/2017.
5. Lejen Mjedisore Komunale, me nr. 07/351/01-23438, dt.01.12.2017, i lëshuar nga DUMM.
6. Vendimin për Kushte Ndërtimore, me nr. 07-351/01 –19663 të datës 19.10.2017, të lëshuar nga DUMM.
7. Pëlqimin mbi ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me numër 3865/3 të datës 03.11.2017, të lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, RKS.
8. Njoftimin e datës 01.12.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Komuna e Gjakovës.
9. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr. 430/b/611, të datës 23.10.2017.
10. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr.1762 të datës 25.10.2017.
11. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A. Gjakovë, nr.2998 të datës 26.10.2017.
12. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 23.10.2017.
13. Vërtetimin nga K.R.M."Çabrati", me numër 1024, dt.24.10.2017.
14. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Pro Credit Bank, filiali Gjakovë me datë 01.12.2017.
15. Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar ndërmarrja projektuese "INEX-PROJECT"-Gjakovë.

Taksa administrative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 1095.85 Euro.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arkivit.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur. i dipl.

U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark.




K.K. GJAKOVË

Zona kadastrale : UJZ

Parcela nr. 494-3

PLAN SITUACIONI



Gjendja kadastrale

Gjendja faktike



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government


Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GJAKOVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Ujz

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-70713080-00494-3	Pracelë / Parcela / Parcel	1100,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2500

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 05.10.2017

Koha/ Vreme/ Time: 09:51:21

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovui/Usvojio/Aproved: MCO GJAKOVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture: